



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NE FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 399/prot.

Tiranë, më 08.11.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1713, datë 30.05.2014.

**SHOQËRISË “ART MILANI” SH.P.K
Fshati Domen, Postribë, Malësi e Madhe, Shkodër.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Art Milani” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1713, datë 30.05.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Rripa e Domnit”, Postribë, Malësi e Madhe, Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresat nr.223 prot., datë 09.01.2018 e nr. 4153 prot., datë 18.04.2018, protokolluar respektivisht në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.399 prot., datë 09.01.2018 dhe nr.6431 prot., datë 18.04.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1713, datë 30.05.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Rripa e Domnit”, Postribë, Malësi e Madhe, Shkodër, për arsye se:

- Nuk është paguar vlera e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për vitin 2016 – 2017 dhe vitin 207 – 2018 në shumën totale 107 760 lekë për dy vitet, siç është përcaktuar në germën “ç”, të nenin 25 dhe në pikën nr.3, të nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
- Është ndërprerë puna për me shume se një vit pa njoftuar më parë strukturat përgjegjëse.
- Nuk është miratuar programi vjetor i punës për vitin 2017 – 2018.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gerrat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për te

cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1713, datë 30.05.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Rripa e Domnit”, Postribë, Malësi e Madhe, Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1713, datë 30.05.2014, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Rripa e Domnit”, Postribë, Malësi e Madhe, Shkodër.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

